

**VENDIM**  
**Nr. 863, datë 21.10.2015**

**PËR KRIJIMIN E BAZËS TË TË DHËNAVE SHTETËRORE TË QENDRËS  
KOMBËTARE TË REGJISTRIMIT, REGJISTRI TREGTAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”, dhe të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Objekt i këtij vendimi është krijimi i bazës të të dhënave elektronike të regjistrit tregtar, të quajtur Regjistri Tregtar.

2. Regjistri tregtar është një bazë të dhënash unike e subjekteve që, sipas legjislacionit shqiptar, kryejnë veprimtari ekonomike tregtare.

3. Në Regjistrin Tregtar reflektohen si të dhëna parësore:

- a) të dhënat që i përkasin themelimit dhe veprimtarisë së subjekteve tregtare;
- b) të dhënat që i përkasin çregjistrimit;
- c) çdo ndryshim në status dhe organizimin e subjektit tregtar;
- ç) të dhënat që u përkasin regjistrimeve me vendim të autoritetit publik;
- d) të dhënat e identifikimit për personin juridik, si forma, emri, numri e vendi i regjistrimit dhe selia;

dh) të dhëna për dokumentet shoqëruese/akte dhe informacione që regjistrohen, njoftohen apo depozitohen në regjistër;

- e) të dhëna për ndërveprim dhe baza të dhënash të tjera;
- ë) të dhënat që i përkasin numrit unik të identifikimit të subjektit;
- f) të dhënat për emrin e subjektit tregtar dhe emrin tregtar;
- g) të dhëna për subjektet e huaja;
- gj) të dhëna për kapitalin themeltar të anëtarëve/aksionarëve/ortakëve;
- h) kompetencat e përfaqësimit dhe afatet e emërimit të personave përgjegjës për administrimin dhe përfaqësimin e shoqërisë në marrëdhënie me të tretët.

4. Regjistri Tregtar përmban informacione për subjektet që detyrohen të regjistrohen në regjistrin tregtar sipas ligjit, si:

4.1 Të dhënat e detyrueshme për personat fizikë

Për regjistrimin fillestar të personave fizikë janë të detyrueshme të dhënat për:

- a) vendin e ushtrimit të veprimtarisë ekonomike tregtare;
- b) fushën e veprimtarisë, në qoftë se është e përcaktuar;
- c) specimenin e nënshkrimit (firmës) të personit fizik.

4.2 Të dhënat e detyrueshme për shoqëritë e thjeshta

Për regjistrimin fillestar të shoqërive të thjeshta janë të detyrueshme të dhënat për:

- a) kohëzgjatjen, në qoftë se është e përcaktuar;
- b) fushën e veprimtarisë, në qoftë se është e përcaktuar;
- c) vendin e ushtrimit të veprimtarisë ekonomike tregtare;
- ç) vlerën dhe llojin e kontributeve të anëtarëve;
- d) kompetencat e përfaqësimit, si dhe afatet e emërimit të personave përgjegjës për administrimin dhe përfaqësimin e shoqërisë në marrëdhënie me të tretët;

dh) specimenet e nënshkrimit (firmave) të personave, që përfaqësojnë shoqërinë përpara të tretëve.

4.3 Të dhënat e detyrueshme për shoqëritë tregtare

Për regjistrimin fillestar të shoqërive tregtare janë të detyrueshme të dhënat për:

- a) emrin;

- b) formën;
- c) datën e themelimit;
- ç) selinë;
- d) objektin, në qoftë se është i përcaktuar;
- dh) kohëzgjatjen, në qoftë se është e përcaktuar;
- e) kompetencat e përfaqësimit, si dhe afatet e emërimit të personave përgjegjës për administrimin dhe përfaqësimin e shoqërisë në marrëdhënie me të tretët;
- ë) specimenet e nënshkrimit (firmave) të personave, që përfaqësojnë shoqërinë përpara të tretëve;
- f) njoftimin e vlerës së kapitalit themeltar të nënshkruar, numrin e pjesëve të kapitalit, vlerën nominale të secilës pjesë, pjesëmarrjen në kapital, vlerën dhe llojin e kontributeve të secilit ortak, si dhe informacionin nëse kapitali fillestar i nënshkruar është paguar ose jo.

#### 4.4 Të dhënat shtesë për shoqëritë aksionare

Për regjistrimin fillestar të shoqërisë aksionare, përveç sa parashikohet në nenin 32, të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, të ndryshuar, janë të detyrueshme edhe të dhënat për:

- a) vlerën e kapitalit themeltar të nënshkruar dhe pjesën e paguar;
- b) numrin dhe formën e aksioneve të nënshkruara;
- c) vlerën nominale të secilit aksion;
- ç) numrin i aksioneve të nënshkruara nga secili aksionar;
- d) vlerën dhe llojin e kontributit të secilit aksionar, si dhe pjesën e paguar prej secilit;
- dh) kushtet e veçanta, që kufizojnë transferimin e aksioneve (nëse ka);
- e) nëse ka kategori të ndryshme aksionesh, njoftohen të dhënat e përcaktuara në shkronjat “c” e “dh”, të kësaj pike, për secilën kategori aksionesh, si dhe të drejtat që lidhen me to;
- ë) procedurat për konvertimin e formës së aksioneve, nëse parashikohet në statut;
- f) vlerën totale ose një parashikim të kostove të veçanta në ngarkim të shoqërisë për procedurat e themelimit;
- g) përparësitë që u njihen personave, që kanë marrë pjesë në themelimin e shoqërisë apo në transaksione të veçanta, që lidhen me fillimin e veprimtarisë ekonomike (nëse ka);
- gj) identifikimin e anëtarëve të këshillit mbikëqyrës dhe ekspertit kontabël të autorizuar, si dhe afatin e emërimit të tyre;
- h) numrin e anëtarëve të organeve drejtuese;
- i) procedurat e emërimit të anëtarëve të organeve drejtuese, nëse ndryshojnë nga parashikimet ligjore.

#### 4.5 Të dhënat për degët dhe zyrat e përfaqësimit të shoqërive të huaja

Për regjistrimin fillestar të degëve dhe zyrave të përfaqësimit të shoqërive të huaja janë të detyrueshme të dhënat për:

- a) shoqëritë e huaja, si:
  - i) emri;
  - ii) forma;
  - iii) data e themelimit;
  - iv) të dhënat e identifikimit të themeluesve;
  - v) selia;
  - vi) objekti, në qoftë se është i përcaktuar;
  - vii) kohëzgjatja, në qoftë se është e përcaktuar, përfshirë numrin dhe vendin e regjistrimit;
  - viii) kapitalin e shoqërisë së huaj;
- b) emrin e degës ose të zyrës së përfaqësimit, nëse është i ndryshëm nga ai i shoqërisë së huaj;
- c) kohëzgjatjen e degës ose të zyrës së përfaqësimit, në qoftë se kjo është e përcaktuar;
- ç) fushën e veprimtarisë së degës ose të zyrës së përfaqësimit, në qoftë se kjo është e përcaktuar;
- d) selinë e degës ose të zyrës së përfaqësimit;

dh) të dhënat e identifikimit të personave përgjegjës për administrimin dhe përfaqësimin e degës ose zyrës së përfaqësimit në marrëdhënie me të tretët nëse është shtetas i huaj, kompetencat e përfaqësimit dhe afatet e emërimit;

e) specimenet e nënshkrimit (firmave) të personave, që përfaqësojnë degën ose zyrën e përfaqësimit në marrëdhënie me të tretët.

#### 4.6 Të dhënat për shoqëritë dhe unionet e kursim-kredive

Për regjistrimin e shoqërive dhe të unioneve të kursim-kredive janë të detyrueshme për regjistrim të dhënat për:

a) emrin;

b) formën;

c) datën e themelimit;

ç) identifikimin e themeluesve;

d) selinë;

dh) objektin, në qoftë se është i përcaktuar;

e) kohëzgjatjen, në qoftë se është e përcaktuar;

ë) kompetencat e përfaqësimit, si dhe afatet e emërimit të personave përgjegjës për administrimin dhe përfaqësimin e shoqërisë në marrëdhënie me të tretët;

f) specimenet e nënshkrimit (firmave) të personave, që përfaqësojnë shoqërinë përpara të tretëve;

g) vlerën e kontributeve të secilit anëtar në kapitalin e shoqërisë, faktin nëse kapitali i nënshkruar është i paguar dhe pjesën e paguar, si dhe afatin e emërimit të anëtarëve të organit mbikëqyrës e të ekspertit kontabël të autorizuar.

#### 4.7 Të dhënat për shoqëritë e bashkëpunimit të ndërsjellë

Për regjistrimin e shoqërive të bashkëpunimit të ndërsjellë janë të detyrueshme të dhënat për:

a) emrin;

b) formën;

c) datën e themelimit;

ç) identifikimin e themeluesve;

d) selinë;

dh) objektin, në qoftë se është i përcaktuar;

e) kohëzgjatjen, në qoftë se është e përcaktuar;

ë) kompetencat e përfaqësimit, si dhe afatet e emërimit të personave përgjegjës për administrimin dhe përfaqësimin e shoqërisë në marrëdhënie me të tretët;

f) specimenet e nënshkrimit (firmave) të personave, që përfaqësojnë shoqërinë përpara të tretëve;

g) vlerën e kontributeve të secilit anëtar në kapitalin e shoqërisë, faktin nëse kapitali i nënshkruar është i paguar dhe pjesën e paguar, përcaktimin e territorit të veprimtarisë, si dhe afatin e emërimit të anëtarëve të organit mbikëqyrës, të ekspertit kontabël të autorizuar.

#### 5. Regjistri Tregtar përmban gjithashtu informacione dhe dokumente, si më poshtë vijon:

a) Pasqyrat financiare vjetore, raportin e ecurisë së veprimtarisë, raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe raportin e auditimit, të mbajtur sipas kërkesave ligjore, në rastet kur mbajtja e këtyre dokumenteve është e detyrueshme;

b) Aktin e emërimit ose të shkarkimit të ekspertit kontabël të autorizuar, në rastet kur emërimi është i detyrueshëm, numrin e licencës profesionale;

c) Aktin e emërimit të likuiduesve;

ç) Aktet e prishjes, mbylljes apo shpërndarjes, aktet e transformimit, bashkimit, ndarjes, hapjes së procedurave të administrimit, likuidimit ose riorganizimit, si dhe aktet e tjera të ndërmjetme, të parashikuara nga legjislacioni në fuqi. Për degët dhe zyrat e përfaqësimit të shoqërive të huaja regjistrohen edhe aktet e transformimit, të bashkimit, ndarjes, hapjes dhe mbylljes së procedurave të likuidimit ose falimentimit të shoqërisë së huaj;

d) Të dhëna për vendet e tjera të ushtrimit të veprimtarisë, të ndryshme nga selia;

dh) Dokumentet, që vërtetojnë vënien e pengjeve ose garancitë e tjera për pjesëmarrjet në

kapitalin e subjektit;

- e) Çdo regjistrim tjetër të detyrueshëm sipas dispozitave ligjore në fuqi;
- ë) Listën e plotë të aksionarëve të regjistruar;
- f) Vendime gjyqësore ose të autoriteteve të tjera publike për të dhënat e regjistruara ose veprimtarinë e subjektit tregtar;
- g) Certifikatën e regjistrimit fillestar (Numri unik i identifikimit të subjektit NUIS).

5.1 Regjistri Tregtar përmban edhe të dhëna shtesë (vullnetare), të cilat përfshijnë, por pa u kufizuar në to,;

- a) emërtimin ose shenjat e tjera dalluese të veprimtarisë (nëse është/janë i/të ndryshëm nga emri i regjistruar i subjektit);
- b) çdo transferim të aksioneve nominative për shoqëritë aksionare që, përveç personave të autorizuar, mund të regjistrohet edhe me aplikimin e çdo aksionari të interesuar;
- c) website, e-mail, telefon dhe faks;
- ç) vendimet e organeve drejtuese të subjektit, të ndryshme nga vendimet e detyrueshme për regjistrim;
- d) të dhëna të tjera, të lidhura me veprimtarinë ekonomike tregtare të subjektit;
- dh) vendimin e pezullimit të veprimtarisë ose vendime të tjera të ndryshme nga vendimet e detyrueshme për regjistrim.

5.2 Të dhëna për subjektet e çregjistruara, si numri e data e vendimit gjyqësor ose e autoritetit tjetër publik, sipas ligjeve të posaçme, që ka vendosur çregjistrimin nga regjistri tregtar, ose, në rastin e çregjistrimit vullnetar, të dhënat e aktit të aplikimit, nëpërmjet të cilit është kryer çregjistrimi.

5.3 Të dhënat sipas legjislacionit tatimor, të sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe atij të statistikave, si:

5.3.1 Llojet e tatimeve për të cilat subjekti është përgjegjës:

- a) Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël;
- b) Sigurime shëndetësore;
- c) Sigurime shoqërore;
- ç) TVSH-në;
- d) Lojëra fati;
- dh) Tatimfitimi;
- e) Tatimi i të ardhurave nga punësimi;
- ë) Taksa kombëtare.

5.3.2 Kategori për sigurimet shoqërore të subjektit:

- a) Punëdhënës me punëmarrës;
- b) I vetëpunësuar i vetëm;
- c) I vetëpunësuar me punëmarrës;
- ç) I vetëpunësuar me punëmarrës dhe punonjës të papaguar të familjes;
- d) I vetëpunësuar pa punëmarrës dhe punonjës të papaguar të familjes.

5.3.3 Kodi i Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike (NVE 2).

6. Të dhëna dytësore konsiderohen të dhënat që kanë të bëjnë me të dhëna referencare të Gjendjes Civile, si numri personal, emri, mbiemri, atësia, vendlindja, datëlindja, gjinia, bashkia/komuna, adresa.

7. Baza e të dhënave të Regjistrit Tregtar ndërvepron me bazat e të dhënave të:

- administratës tatimore, qendrore dhe vendore;
- Institutit të Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore;
- Inspektoratit Kombëtar të Punës;
- institucioneve të tjera publike/private, me të cilat QKR-ja lidh marrëveshje.

8. Qendra Kombëtare e Regjistrimit është administratori i vetëm i Regjistrit Tregtar dhe përgjegjëse e drejtpërdrejtë për strukturën e bazës të të dhënave, anën funksionale dhe operacionale.

9. Qendra Kombëtare e Regjistrimit përfaqëson autoritetin e vetëm, i cili përcakton të drejtat dhe kufizimet e operimit në bazën e të dhënave elektronike të Regjistrit Tregtar, nëpërmjet aplikimit të skemave të aksesit me nivele të shkallëzuara dhe hierarkike të administrimit të informacionit respektiv për të gjitha institucionet e tjera të administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore.

10. Qendra Kombëtare e Regjistrimit është përgjegjëse për krijimin, operimin dhe mirëfunksionimin e të gjithë përdoruesve me privilegje aksesit të nivelit të parë të bazës të të dhënave elektronike të Regjistrit Tregtar dhe, po ashtu, miraton krijimin e përdoruesve e monitoron operacionet e të gjithë këtyre përdoruesve të tjerë me privilegje aksesit të nivelit të dytë.

11. Institucioni administruar dhe përgjegjës i bazës të të dhënave të Regjistrit Tregtar dhe procesit të regjistrimit është Qendra Kombëtare e Regjistrimit.

12. Dhënës të informacionit janë:

- a) gjykata;
- b) prokuroria;
- c) dogana;
- ç) përmbartimi shtetëror dhe privat;
- d) autoritete publike/private me të cilat QKR-ja lidh marrëveshje apo ka detyrimin në bazë të ligjeve të posaçme;

dh) individë dhe subjekte (fizike dhe juridike).

13. Subjekte të interesuara janë:

- a) Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.
- b) Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.
- c) Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.
- ç) Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave.
- d) Policia e Shtetit, prokuroria apo agjenci të tjera të hetimit.
- dh) Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive.
- e) Institucione të tjera publike apo private.

14. Niveli i aksesit në sistemin dhe bazën e të dhënave të Regjistrit Tregtar është, si më poshtë vijon:

a) Veprimet në regjistër kryhen nga Drejtori i Përgjithshëm i QKR-së dhe/apo nga nëpunësit regjistruar, të përcaktuar në strukturën e QKR-së;

b) Veprimet në regjistër kryhen nga nëpunës të sporteleve të shërbimit në QKR qendër dhe në njësitë e qeverisjes vendore dhe nëpunësit e sporteleve që hapen pranë dhomave të tregtisë dhe industrisë, rregulluar sipas legjislacionit përkatës;

c) Nëpunësi i regjistrimit dhe nëpunësi i sportelit kanë të drejtë leximi mbi të dhënat e parësore dhe dytësore;

ç) Nëpunësit e sportelit kanë të drejtë leximi, shkrimi dhe modifikimi mbi të dhënat e të gjithë individëve dhe subjekteve;

d) Drejtori i Përgjithshëm është autoriteti përgjegjës për veprimet në regjistra.

15. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Regjistrimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

**Edi Rama**